



Perspektiva juaj  
është sfida jonë!

Fondi më i ri në fushën e investimeve



## Raport Muaji Qershori 2020

### Informacion bazë

Administrimi i Fondit

Monedha

Datë Lancimi

Datë e mbarimit te Ofertes  
Fillestare

Vlera fillestare e kuotës

Shuma fillestare minimale

Shuma minimale pasuese

Komision në hyrje

Komision në dalje

Komision Administrimi në vit  
Kosto për transfertë fondesh  
nga palë të treta

Shoqëria  
**Raiffeisen Invest**  
sh.a

**LEK**

**20 Gusht 2018**  
**03 Shtator 2018**

**1,000**

**30,000**

**10,000**

**0%**

**2% (cdo shlyerje  
para 2 viteve)**

**1.25%**

**Referojuni  
informacionit ne  
deget e RBAL**

### Objktivi i investimit dhe profili i investitorit

Objktivi i Fondit është të maksimizoje kthimin total afatmesëm, duke synuar të ruajë kapitalin e investitorit dhe të sigurojë likuiditet të mjftueshmëm.

Fondi synon të ketë një portofol investimesh të përqëndruar kryesisht në instrumente borxhi të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Për të maksimizuar kthimin total nga investimi, Fondi synon investime afatgjata dhe për këtë arsy, fondi investon të paktën 50 – 80% të aseteve ne obligacione afatgjatë te Qeverisë shqiptare.

### Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik i ulët

Përfitimet tipike më të ulëta

Rrezik i lartë

Përfitimet tipike më të larta

1

2

**3**

4

5

6

7

Profili i parashikuar i Rrezikut dhe Përfitimit të fondit Raiffeisen Vizion i përket kategorisë së tretë.

Ky nivel i treguesit është rezultat i aplikimit të politikës së investimit të fondit me të dhënat historike të normave të interesit për 5 vitet e fundit.


Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik. Ky tregues ka për qëllim tju informoje mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës se fondit. Të dhënët historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

### Të dhëna për Fondin në 30.06.2020

<b>Vlera Neto e Aseteve</b>	<b>12,059,245,927</b>
<b>Numri i investitoreve</b>	<b>4,251</b>
<b>Cmimi i Kuotes</b>	<b>1,066.7910</b>
<b>*Kthimi nga investimi (30.06.2019 - 30.06.2020)</b>	<b>2.09%</b>

\*Komisioni i administritimit zbritet përparrë llogaritjet së kthimit nga investimi

### Struktura e portofolit te investimeve ne 30 Qershori 2020



Ne kuader te politikes se investimit te fondit Vizion, investimet do te kryhen kryesisht ne obligacione thesari, te emetuara ose garantuara nga Qeveria shqiptare, permes pjesemarrjes ne ankandet e tregut primar dhe transaksioneve ne tregun sekondar. Politika e investimit parashikon qe te pakten 50 – 80 % e aseteve te fondit do te investohen ne obligacione afatgjate te Qeverise se Republikes se Shqiperise. Bonot e thesarisit 12 mujore emetohen dy here ne muaj; Obligacionet 2 vjeçare nje here ne muaj; 7 dhe 10 vjeçare jane me te rralla, afersisht nje here ne tre muaj. Qeveria organizon ankande te obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuencë nje here ne 2 muaj per secilin maturitet.

Instrumenti	Ne % te Aseteve te Fondit
Bono Thesari	1.64%
Obligacione Thesari	86.37%
Depozita / Llogari rrjedhese/ Te arketueshme	11.99%

Ne fund te muajit Qershori, obligacionet e thesarit te Qeverise Shqiptare perbejne 86.37% te totalit te aseteve te fondit dhe 1.64% jane te investuara ne Bono thesari. Pjesa e likuiditetit afatshkurter (depozita) eshte 11.99% e portofolit te investimeve. Vlera neto e aseteve te fondit eshte ne nivelin e LEK 12.06 miliarde ne date 30 Qershori 2020.

## Zhvillimet dhe ecuria e normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare gjate muajit Qershori

Gjate muajit Qershori tregjet nderkombetare te kapitalit dhe ekonomia botore vazhduan procesin e rikuperimit nga situata e veshtere financiare e krijuar gjate pandemise globale. Edhe ne vendin tone ka patur një gjallerim te aktiviteteve ekonomike por gjithashtu edhe raste te shtuara me Covid-19 për shkak të ekspozimit më të lartë ndaj virusit dhe përhapjes së tij në të gjitha qytetet.

Asetet e Fondit Vizion jane te investuara vetem ne bono dhe obligacione te emetuara nga Qeveria e Republikës se Shqiperise dhe per kete arsyre fondi eshte i eksposuar ndaj ndryshimeve ne normat e interesit te ketyre titujve. Keshtu investimet e fondit nuk kane lidhje direkte me tregjet nderkombetare, por impaktohen kryesisht nga zhvillimet ne tregun e brendshem sic jane ndryshimet ne normat e interesit te titujve te Qeverise Shqiptare.


Pergjate muajit Qershori ne tregun vendas normat e interesit te titujve te emetuar nga Qeveria Shqiptare filluan te kene një trend ne renie, sidomos titujt afatshkurter. Ky trend i atribuohet pjesemarrjes se larte ne ankandet e tregut primar dhe nivelit te larte te likuiditetit ne treg.

Yield-i mesatar i ponderuar ne ankandin primar per Bono Thesari 12-mujore rezultoi ne 1.93%, duke pesuar renie me 0.15% krahesuar me normen e vendosur ne ankandin e fund muajit Maj qe ishte 2.077%.

Persa i perket ankandeve te obligacioneve, u rihap ankandi i obligacionit 2 vjeçar-i i emetuar ne LEK dhe rezultoi ne 2.20%, duke rene me 0.35% ne krahesim me ankandin e rihapur ne muajin Maj; ndersa obligacioni 7-vjecar i emetuar ne LEK ra vetem me 0.03% krahesuar me ankandin e fundit qe ishte organizuar ne Mars. Gjithashtu u zhvillua dhe obligacioni reference 3-vjeçar i emetuar ne LEK, i cili rezultoi ne 2.58%, duke rene me 0.34% ne yield krahesuar me ankandin e fundit qe ishte organizuar ne Prill.

Lehtesimi i sitates se pandemise ne vend, masat e ndermarra nga Qeveria per rifillimin e aktivitetit ekonomik, dhe dalja e sukseshme me Eurobond ne tregjet nderkombetare nga ana e Qeverise Shqiptare, bene qe normat e interesit te titujve te Qeverise te pesonin renie ne tregun vendas gjate muajit Qershori dhe parashikohet qe ky trend renes te vazhdoje edhe ne muajt ne vijim.

Grafiku me poshte jep një pasqyre te ecurise se normave te interesit te bonove dhe obligacioneve te thesarit te emetuar nga Qeveria Shqiptare gjate periudhes 1-vjeçare Qershori 2019 – Qershori 2020. Per obligacionet reference 3 dhe 5 vjeçare jane paraqitur yields fiks te perllogaritura nga kuotimet e kontributoreve ne fund te muajit Qershori.




## Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri ne 30 Qershori 2020

Çmimi i kuotes se fondit Vizion ka patur rritje me 0.43% gjate muajit Qershori. Çmimi i kuotes eshte rritur me 3.61% me baze vjetore qe nga fundi i periudhes se ofertes fillestare ne 3 Shtator 2018 deri ne 30 Qershori 2020.

Ndersa kthimi me baze vjetore, per periudhen 30 Qershori 2019 – 30 Qershori 2020 eshte 2.09%.

Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut, sic Jane ndryshimet e normave te interesit te tituve te borxhit te emetuar nga Qeveria Shqiptare. Keshtu kur normat e interesit ne treg rriten, vlera e tituve te portofolit ulet dhe per rrjedhoje ulet dhe norma e kthimit per periudhen e kaluar. E kunderta ndodh kur normat e interesit ulen. Per pasoje, çmimi i kuotes mund te jete i luhatshem. Luhatshmeria eshte pjese e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi i saj eshte i pamundur, keshtu çmimi i kuotes mund edhe te bjere, jo vetem te rritet.



Fondi Vizion aplikon nje periudhe minimale qendrimi ne fond prej 2 vitesh. Cdo shlyerje perpara permbushjes se periudhes 2-vjet, do te jetë subjekt i nje tarife dalese prej 2% e vleres se kuotave te shlyera.

Pertej minimumt kohor te qendrimit ne fond, Investitorët e fondit Vizion dhe te gjithe fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfituar nje kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter.

Per fondin Vizion ky horizont i rekomanduar i qendrimit ne fond eshte te pakten 3 vjet, duke patur parasysh natyrën afatgjatë të investimeve të parashikuara në strategjinë e investimit të fondit dhe ne menyre qe te permbushet objektivi i performancës së fondit.

Investitorët inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond te nxitur nga situata jo e zakonshme e krijuar nga pandemia globale, sepse ne kete menyre nuk do te rrezikojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Të dhënat per kthimin nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë nje premtim apo garanci per kthimin ne te ardhmen. Te gjithe shembujt e tjere numerike, jane perdonor per qellime ilustrative dhe analize te te dhenave historike, dhe nuk duhen perdonor nga investitorët per te nxjerre konkluzione per te ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit.

Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojne nje kthim te caktuar te fondit. Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrate të Raiffeisen Invest sha., në web site [www.raiffeisen-invest.al](http://www.raiffeisen-invest.al) ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.